

BIBLIOTEKA I NATIONESIT

BIBLIOTEKA
SHTETIT

19-1-821

483

AŞDRENI



**Poezi
të zgjedhura**

SH-A-821
A-83

BIBLIOTEKA E NXENESIT


ALEKS STAVRE DRENOVA

(Asdreni)

POEZI
TË ZGJEDHURA



11435



A S D R E N I
(1872-1947)

ASDRENI DHE POEZIA E TIJ

Aleks Stavre Drenova, me pseudonimin Asdreni, është një nga shkrimtarët më të rëndësishëm të letërsisë sonë të kaluar. Me përbajtjen përparimtare dhe karakterin popullor të poezisë së tij, ai u bë një nga figurat më të shquara në periudhën e fundit të Rilindjes dhe më vonë të Pavarësisë. Vazhdues i denjë i Naimit, i Çajupit etj., ai jo vetëm që i trajtoi me patos të fuqishëm gjithë motivet e letërsisë së Rilindjes, por i pasuroi këto me elemente të reja, sidomos duke e afruar poezinë e tij me jetën e popullit, duke forcuar elementet realiste.

Lindi në Drenovë të Korçës më 1872 në një familje të varfër dhe, ndonëse pjesën më të madhe të jetës e kaloi në mërgim, mbeti një bir i thjeshtë i popullit e i atdheut të vet, të cilit i kushtoi punën dhe talentin. Në jetën e Asdrenit ndikuan disa fak-

torë të veçantë politiko-shoqërorë e kulturorë, jehona e të cilëve u pasqyrua me mjaft besnikëri edhe në vjershat e tij.

Kështu, pasi emigroi në Rumani që në moshën 13-vjeçare, poeti i ardhshëm u formua në atmosferën plot patos patriotik të kolonisë shqiptare të Bukureshtit, që ishte një nga vatrat më të rëndësishme të lëvizjes së Rilindjes Kombëtare. Këtu ishte formuar që më 1880 Dega e Shoqërisë së Stambollit për villa (libra) shqip (me emrin «Drita»), e cila botoi një numër të madh librash të figurave kryesore të Rilindjes: Naimit, Samiut, Vretos etj. Kjo vatër patriotike e tërhoqi menjëherë në gjirin e vet drenovarin e ri, i cili më 1892 u bë anëtar i shoqërisë «Drita» dhe një nga veprimtarët më të shquar në radhët e patriotëve shqiptarë të Rumanisë. Më vonë organizoi dhe mori pjesë edhe në shoqëri të tjera patriotike që mbronin interesat e popullit shqiptar dhe demaskonin intrigat e armiqve. Pas një udhëtimi që bëri në Shqipëri, ku pa prapambetjen, shtypjen dhe sundimin më të egër feudal, më 1894 shkruante: «*Eshtë detyra jonë të mos e lëmë vegjelinë ndër thonjtë e mprehtë të parësisë, po të kërkojmë t'i shërojmë plagët e gjakta, të dhemburit e të cilave e ndien gjer në palcë*».

Nën ndikimin e veprave të Naimit dhe të mjesdit të ndezur patriotik të Bukureshtit, Asdreni filloi krijimet e para poetike. Vjershat e tij «*Mallkimi*», «*Ardhi dita*» etj. tërhoqën vëmendjen dhe emri i tij filloi të dukej gjithnjë e më shpesh në shtypin e atëhershëm. Edhe pse pati ndonjë ndikim nga lirika evropiane dhe rumune e kohës, vjershat e tij kanë karakter të theksuar kombëtar e pa-

triotik. Kjo është arsyjeja që përbledhjen e tij të parë poetike «*Rreze dielli*» (1904) e çmuani dhe e vlerësuan patriotët bashkëkohës, ndonëse kjo dilte 2 vjet më vonë se vepra madhore e Çajupit «*Baba Tomori*», e cila kishte bërë jehonë të madhe.

Rugën poetike Asdreni e filloi si romantik. Me një ton të ngritur e optimist, ai i këndoi atdheut dhe trajtoi, ashtu si dhe paraardhësit e tij, problemet më të mprehta që shtroheshin para lëvizjes kombëtare. Me një mall të zjarrtë për Shqipërinë, u bëri thirrje shqiptarëve të zgjoheshin nga gjumi e të bashkoheshin, evokoi të kaluarën dhe figurat e shquara si Skënderbeu etj., ngriti lart traditat liridashëse të popullit, duke kërkuar prej tij që të luftonte e të sakrifikonte gjithçka për lirinë dhe paravësinë kombëtare.

Në vitet 1908-1912, si pasojë e zhvillimit të ngjarjeve politike, horizonti poetik i Asdrenit u zgjerrua në mënyrë të ndjeshme, u forcua fryma demokratike e vjershave të tij, të cilat u prirën nga realizmi. Kështu, ai goditi xhonturqit dhe demagogjinë e tyre dhe sidomos demaskoi egoizmin e parisë shqiptare në vjersha të tilla, si: «*Shpérblimi*», «*Kerrière tradhtarë*», «*Zëri i kryengritësve*», ku përballe indiferentizmit të shtresave të pasura ndaj fateve të atdheut dhe shpirtit të tyre lakmitar e mizor, vë popullin e thjeshtë patriot, të cilin e sheh si shtyllën e luftës për çlirimini kombëtar. Një hap përpëra shënon sidomos vjersha «*Lulëkuqja*», në simbolikën e së cilës duket dhe ndikimi i ideve socialiste të kohës. Siç shihet, poezia e Asdrenit pasurohet me probleme të rëndësishme shoqërore.

Veç motivit patriotik e shoqëror, Asdreni lë-

vroi dhe lirikën e natyrës, ku na vizatoi tablo plot ngrrohtësi e dritë të fshatit të lindjes. Këto vjersha ishin edhe fryt i përfytyrimeve që kishte ai për fshatin, si një kënd i paprekur nga morali borgjez, si një mjesdis ku rridhete një jetë e çiltër, plot punë dhe gjëzime të thjeshta njerëzore. Natyrisht, gjendja reale e fshatit shqiptar nuk ishte e tillë.

Asdreni trajtoi dhe temën e dashurisë. Këto vjersha janë të thjeshta e të gjitra.

Me shumicën e vjershave të shkruara në pragun e shpalljes së pavarësisë Asdreni botoi më 1912 vëllimin «*Endrra e lot*», me të cilin mbyllat periudha e parë e krijimtarisë poetike të tij.

Aktiviteti letrar i Asdrenit u shtri në një kohë mjaft të gjatë, plot ngjarje të trazuara e plot përleshje klasore. Ai punoi në periudhën e luftës përgjirim nga zgjedha shekulllore otomane dhe të përpjekjeve të forcave përparimtare pér ta çuar Shqipërinë në rrugën e zhvillimit të gjithanshëm. Por në këto momente historike edhe mbeturinat feudale mesjetare ishin ende të forta dhe pikërisht këto forca reaksionare iu kundërvunë të parave, duke marrë gjoja flamurin e «nacionalizmit», aspak pér të mbrojtur interesat e atdheut, por vetëm e vetëm pér të ruajtur privilegjet e tyre të dikurshme.

Në këto kushte Asdrenin e shqetësonte fati i mëtejshëm i atdheut, rrugët që do të çonin drejt përparimit etj. Që këtu filloi një periudhë tjetër në jetën dhe në veprën e poetit, periudha e rënies. Duke mos mundur të orientohej në ngjarjet e kohës, atij i lindi mosbesimi, e mundonte ideja se gjithçka që kishin bërë patriotët, shkoi kot, se e ardhmja e Shqipërisë mbetej e pasigurt. Edhe pse

Luftha e Vlorës (1920) i ngjalli shpresa me frymën e lartë të patriotizmit dhe me heroizmin që tregoi aty vegjelia (kujto poezinë «*Burri i dheut*»), mesi i viteve '20 e thelloi krizën shpirtërore të poetit.

Bir i fshatarësisë së thjeshtë të përvuajtur, Asdreni jo vetëm që s'u pajtua me shtetin feudo-borgjez zogolian, por i fshikulloi me forcë dhe me urrejtje të papërmbastur qarqet reaksionare anadolake që morën në dorë fatet e popullit. Këtë qëndrim Asdreni e shprehu në mjaft vjersha, nga të cilat po përmendim «*Republika shqiptare*» dhe «*Fisnikët e Shqipërisë*». Por, edhe pse poezia e tij e kësaj kohe pati karakter satirik e goditës, Asdreni nuk e kuptoi që lëvizja demokratike mund të arrinte të zgjidhte detyrat e veta vetëm po të merrte karakter thellësishët revolucionar.

Forcat reaksionare s'ia falën poetit të njojur penëmprehtë qëndrimin e tij. Ato u hakmorën me të në mënyrë të ulët: e shkarkuan nga detyra e sekretarit të konsullatës shqiptare në Bukuresht, duke e lënë kështu pa mjete jetese.

Që nga gjysma e dytë e viteve '20 Asdreni u tërroq në vetmi i dëshpëruar e qëndroi larg lëvizjes demokratike. Pas vitit 1924 notat sunduese në poezinë e tij u bënë pesimizmi dhe fatalizmi. Për këtë ndikoi, veç të tjerash, edhe poezia dekadente e Perëndimit. Megjithatë, edhe në vëllimin e tretë «*Psallme murgu*» (1930), edhe më vonë pati dhe mjaft poezi me përbajtje të shëndoshë. Le të përmendim poemën «*Trashëgimi*» (e kishte nisur që më 1924 dhe e përfundoi më 1935), ku akuzon me një rreptësi të pashoqe forcat e vjetra shoqërore që morën pushtetin në dorë me kundërrrevolucion dhe

e hodhën popullin në një mjerim dhe shtypje çnjerëzore.

Pavarësisht nga pozitat jo të shëndosha ku ra poezia e Asdrenit në fazën e dytë, në përgjithësi vepra e tij mbetet vepra e një patrioti të flaktë dhe e një poeti demokrat. Me lirizmin e theksuar, me frymën demokratike dhe realizmin që përshkon shumë shkrime, me gjuhën e thjeshtë e shprehëse, Asdreni mbetet vazhdues i denjë i veprës së rilindësve.

Asdreni vdiq në dhjetor të vitit 1947.

*

*

*

Në këtë përbledhje jepen disa nga vjershat e zgjedhura të Asdrenit, me një frymë të theksuar patriotike e demokratike. Shënimet përkatëse dhe pyetjet e detyrat me të cilat është pajisur teksti, do t'i ndihmojnë nxënësit ta njojin dhe ta përvetësojnë më mirë e më thellë veprën e poetit tonë të shquar.

N J É D I E L L I R I *

Sot mori fund çdo gjurmë tiranie.
Një diell i ri po ndrit plot me shkëlqim,
për kombin lind një kohë lumturie
dhe për bishat e egra një shkatërrim.

* Vjersha u shkrua në tetor të vitit 1945. Kjo është nga poezitë e fundit të Asdrenit. Sado që ishte larg, në dhe të huaj, ai rrojti në vitet e fundit të jetës së vet me shqetësimet dhe shpresat e reja të atdheut. Ishte kjo ndjenjë e madhe dashurie për Shqipërinë që e shtyu Asdrenin të përshëndeste diillin e lirisë së vërtetë, që agoi në vendin tonë me ngadhënjimin e pushkëve partizane e të gëzohej për ditët e lumbura që solli Partia për popullin shqiptar.

Ai shprehet plot entuziazëm për triumfin e regjimit të vegjëlisë, për të cilin kishte luftuar tërë jetën si poet e si patriot demokrat. Ja c'shkruan vetë poeti në një nga letrat e këtyre viteve: «... siç po shoh nëpër fletoret që i dërgoni këtu, edhe që më pëlqen t'i gjurmoj të gjitha që po bëhen

Ndër malet tonë, shkaba ku ka çerdhen,
filiza rriten sot me gjak të ri,
me vrull e zjarr në gji, rrebesch që derdhen,
të dalin fitimtarë për liri.

Tiranët pa të drejtë, që na shtypnin,
t'iu jemi robër veç për pasuri,
të vritemi për ta veç gjak na lypnin
për me na mbajtur peng në skllavëri.

Mjaft, se s'na mbet durim, o të mallkuar,
me rrojtje t'ashpër, rrojtje si në ferr.
Sot ne ju mbajmë fyjet keq shtrënguar,
dhe ne të shohim jetë pa një vrer.

aty kur venë mbarë për atdheun tënd, se edhe kjo është një dhembshuri për çdo njeri që ka punuar me etje në zemër për vendin e vet, medoemos nuk e lë zemra të mos interesohet se ç'po ngjet, siç u bë me reformën agrare bashkë me të tjera reforma njerëzore... do të ndihem i lumtur ta shoh Shqipërinë të përparuar...»

1. Shpjegoni kuptimin alegorik në figurën e diellit të ri. Pse poeti e titullon kështu vjershën?
2. Strofa 2 – Cilat janë bishat e egra? Po «filizat që rriten sot me gjak të ri»?
3. Komentoni si e shpreh poeti urrejtjen për tiranët e popullit dhe ngazëllimin për fitoren e të shtypurve.
4. Zhvilloni me shkrim temën:

«Ai diell i ri që e ëndërroi Migjeni, që e pëershëndeti me entuziazëm Asdreni, është dielli që ndezi Partia, dielli që agoi me pushkët partizane, ai diell të cilit i ka dhënë një shkëlqim të paparë epoka jonë socialiste».

Sipasim iu ob pësona e njeri
bush ob mështë, mështë ob
tëmjet e tash me qëndrë
tëmjet e tash me qëndrë.

Ezgj vënë ati e dëshirou ed
dëshirë mëdure edheqës
ezgj at ob arzëq'përi eç
ed qëlljet e çigjet eç

B E T I M I M B I F L A M U R *

Himn patriotik

Rreth flamurit të përbashkuar
me një dëshir'e një qëllim,
të gjith'atij duk'iu betuar
të lidhim besën për shpëtim.

Prej lufte veç ai largohet
që është lindur tradhëtor,
kush është burrë nuk frikohet,
po vdes, po vdes si një dëshmor!

* *Himni patriotik* «Betimi mbi flamur» duhet të jetë shkruar nga Asdreni rreth vitit 1907 dhe u botua për herë të parë në organin «Liri e Shqipërisë» në vitin 1912.
«Betimi mbi flamur» u bë himni ynë kombëtar.

Në dorë armët do t'i mbajmë
të mbrojm' atdheun në çdo kënd,
të drejtat tonë ne s'i ndajmë;
këtu armiqtë s'kanë vend.

Se zoti vetë e tha me gojë
që kombe shuhën përmbi dhe,
po Shqipëria do të rrojë;
për të, për të luftojmë ne!

O flamur, flamur, shenj'e shenjtë,
te ty betohemi këtu,
për Shqipërin', atdhen'e shtrenjtë,
për nder' edhe lavdimn' e tu.

Trim, burrë quhet dhe nderohet
Atdheut kush iu bë theror;
për jet'ai do të kujtohet
mbi dhe, mbi dhe si një shenjtor!

1. Vini re patosin e fuqishëm patriotik të këtij himni.
2. Për se i shërben poetit figura e flamurit? Si e organizon ai mendimin, si e ndërton poezinë?
3. Vini në dukje se si e koncepton poeti detyrën ndaj atdheut, ku i zbulon ai vlerat morale të njeriut, qëndrim mban ndaj tradhtarëve.
4. Krahasoni qëndrimin e Asdrenit ndaj tradhtarëve me qëndrimin që mban ndaj tyre Naimi në vjershënn «Tradhtarët».
5. Komentoni bukur, duke u mbështetur edhe në të dhënët e historisë, këto vargje:
... kombe shuhën përmbi dhe,
po Shqipëria do të rrojë,
për të, për të luftojmë ne!

B U R R I I D H E U T *

— Djem, o trima, burra lufte,¹⁾
mos ma patë djalin vallë,
çun sokol e trim me fletë,
pamjeçelur e sygjallë?²⁾

* Poema «Burri i dheut» u shkrua më 1920, pas ngjarjeve të Luftës së Vlorës dhe e frymëzuar nga kjo luftë. Kjo poemë është nga krijimet e pakta që pasqyroi veprën e vegjëlisë në Luftën e Vlorës dhe gjendjen e saj të mjeruar pas fitores. Në të janë shkrirë tonet heroike të epopesë së shkruar me gjakun e vegjëlisë, hovet lirike të zemrës së nënës që i fali djalin e vetëm lirisë, me revoltën klasore të vegjëlisë ndaj parisë së vendit.

Botimi i kësaj poeme më 1930 në vëllimin «Psallme murgu» ishte një guxim i madh që tregoi Asdreni kundër regjimit të Zogut.

1) Vëreni me kujdes se me ç'fjalë u drejtohet nëna bashkëluftëtarëve të të birit.

2) Me këto vargje dhe ato që vijnë më poshtë, jepet portreti fizik dhe moral i djaloshit 20-vjeçar që ka rënë në Luftën e Vlorës. Me fjalët e përdorura, si: «pamjeçelur», «sygjallë», «burrrë malit», «trim me fletë» etj., duket qartë përfytyrimi i heroit sipas motiveve të këngëve popullore.

Shtat të lartë, burrë mali,
trëndafilë m'i kish faqet;
vjet njëzet pothuaj kishte
dhe pa dirsur as mustaqet:
buz'ë tij gjithë me këngë,
në brez fyell, luleshkruar,
më të qarë kur ia merrte,
kodrat ishin duk'ushtuar!

Malli i tij qenë malet
dhe burimet uj'argjendi,
shtrat'i tij qenë bjeshkët,
shokë, lulet e çdo këndi.

Kur pranvera hapte fletët
(se pranverë qe dhe vetë),
s'linte skaj pa mos e shkelur
posht'e lart si shpez'e lehtë.

Për dëshirën e lirisë,
që kur vendi zu të shkelet,
në të parin zë kushtrimi
nisë ënda¹⁾ që t'i çelet.

Për lirin' e vatrës shenjtë,
ku qe lerë, ku qe rritur,
për vëllezër ndënë thundër²⁾
mendja djalit i qe ngritur!...

Me ju bashk'u nis, or burra,
me ju shkoi që të luftonte;
s'kishte prehje, s'kishte gjumë,
Shqipërinë gjith' kujtonte.

1) ënda — dëshira, qejfi

2) ndënë thundër — të shtypur, të vuajtur

Me fustanen¹⁾ porsi dhëndër
 dhe me gunën supit shtënë,
 pushk'e tij posa një nuse
 dhe një flamur në gji vënë.
 As më thoni, bij, o çuna,
 në më rron, apo ka vdekur?
 Se prej mallit tij po tretem,
 se për të në prush jam pjekur!²⁾
 Veç atë kam prej sa pata,
 djalë-zogë si pëllumbi;
 me thërrime vet'e rrita,
 që kur t'atn'e hëngri plumbi.
 Kisha burrë si desh zoti,
 burrë trim e zemërmirë.
 Me nder rrojti sa qe gjallë,
 po pat fundin të vështirë:
 s'di qysh delja pat shpëtuar
 në një luadh për kullotë,
 kur shkoj murgu³⁾ që ta zërë,
 u dërgua tej n'at'botë.⁴⁾
 Jemi bujq e truall s'kemi.⁵⁾

1) fustanen – fustanellën – veshje popullore burrash prej pëlzure të bardhë, me kinda; është karakteristike për krahinat e Jugut.

2) në prush jam pjekur – kam hequr shumë, kam vuajtur.

3) murgu – këtu: i gjori, i varfri

4) u dërgua tej n'at'botë – (eufemizëm) e vranë

5) Nëna e luftëtarit të Vlorës gjen rastin dhe me pak fjalë shpreh me realizëm gjendjen e mjeruar të saj dhe, një-kohësisht, të të gjitha masave popullore. Poeti e bën këtë qëlli-misht. Fjalët e nënës së heroit të vrarë janë një akuzë therëse ndaj klasave të pasura.

zotérinjt'e mbajnë frerin...

As shtëpia s'është jona,
kur u kënda jasht'na qesin.

Për një dru në vatrat tonë,
me të rrahu shpesh na vdesin.

Me se rrojtkë, s'hapin fjalë,
nga të vesh, o bir, kur s'di nga?

Po një jetë plot mungesa,
kur pa buk'e kur pa opinga.

Gjith si kokrra vese djersa
nëpër faqe na kullon.

Tërë ditën shpinëthyer,
punë, punë na kërkojnë.

Në çdo brazdë të par mendës
djersa jonë ka pikuar.

Nga sa korrim, një grusht s'kemi:
veç me nejet¹⁾ nëpër duar...

Qysh jep zogut dallëndyshja
n'goj' ushqimin kur ia bie,
un'ashtu e rrita djalin,
kur në diell'e kur në hije,
të mbjell'n'arë a të korrja,
a me shatën për në vreshtë,
djalin pas gjithmon'e mbaja,
kryever²⁾ e gjer në vjeshtë.

Pres e mjera, pres e shkreta,
të më vijë t'i puth ballin,
se jam plakë ditëshkurtër,
dua zemrës t'ia nxjerr mallin,

1) nejet — nyjet, kallot e bëra nga puna e rëndë

2) kryeverë — fillimi i verës.

mu në syt' e tij të kaltër
dhe mbi flokët si kalliri
t'i vë buzët, t'i vë duart,
t'ia mbshtet kryet drejt te gjiri.

Të më vinte ta martoja
me një nuse vajzë trime
dhe kurorët t'ia u puthja,
ta gëzoja jetën time.¹⁾

Kur erdh'dita q'u nda meje,
erdh më puthi ball'e dorë.

Më zu qafës me mall biri
dhe më la kështu të gjorë.

Lot të nxeh të sysht më binin.
M'u drodh trupi, më ra pika,
kur tha: «Mëmë, lamtumirë»,
sa mes zemrës shkonin thika.

.....

S'di në luftë në ka rënë,
s'di me nder në ka luftuar,
mos armiqve u është dhënë,
mos gjékundi ësht' harruar?²⁾
Se për nder të Shqipërisë
në ra djali, «falur qoftë».
Se nga zemra s'them të keqen;
Shqipëria veçse rroftë!

1) Nëna ka dëshirat dhe ëndrrat e saj si nënë. Edhe ajo do që jeta të mos i kalojë skëterrë, ndaj dhe u shprehet me zemër në dorë shokëve të djalit.

2) Për nënën e heroit, mbi të gjitha vlen liria e atdheut. Ajo do që i biri i saj i vetëm të mos e ketë turpëruar, por t'ia ketë zbardhur faqen në luftë.

— Rri e qetë, mos qaj, motër,
mbaje zemrën, bëhu burrë,
 se yt bir, e lumur mëmë,
e në vdiq, ai s'vdes kurre, ¹⁾
 se t'atillë burra s'vdesin,
gjaku i tyre bëhet vesë,
 q'i çel lulet e lirisë
dhe për kombin janë besë.

Vet'e pamë qysh luftonte,
si luan mbi mal përpjetë;
 pushk'e tij çudira bënte,
binte armiku mu si fletë.

Më çdo msymje qe i pari,
gjith'me këng' e zinte trapin.²⁾
Ku kërciste pushka rëndë,
ish ai q'e merrte vrapin.³⁾

.....

Dhe kur Vlorës iu afroan,
rreth me tela gjemba-gjemba,
 me zë thirri: «Djem, përpara,
djem, në keni gjak në rrëmba!»

Dhe merr sulmin trim-i rrallë,
se në hovet i kish ënda.

E shtron gunën, ne pas tij
dhe matanë të gjith'brenda.

1) Ata që dhanë jetën për lirinë e atdheut, mbetën të pavdekshëm.

2) trap-i — këtu: hendeku, llogorja

3) ish ai q'e merte vrapin — që hidhej i pari në sulm

Tej nga deti, porsi breshër,
poplat zjarri hekur-rrumbull,¹⁾
të mallkuarat na korrnin,
kur që sipër binin grumbull.

.....

Prij me flamurin q'e kishte
në gji vënë si një korë,²⁾
syrin soje³⁾ nuk e hiqte,
pushka-lule gjith'në dorë.

Tej armiqtë sa na panë,
me gjith'armët, u hutuan,
aq shqiptari të jet'i zoti,
kurrë, besa, s'e besuan.

Nga gjith'anët pushka binte,
në vesh plumbat vërvshëllenin.

Ne mbi gunat, trupin zvarrë,
shkuam telat si s'pandehnin.

Kur u poqëm ballafaqe,
u ra pika, mënt u vranë,
«Falje, falje!» po bërtisinin,
ngritën duart dhe u dhanë.⁴⁾

Kushedi se sa nuk ishim,
një grusht veta,⁵⁾ po më tepër
ish dëshira jon' e zjarrtë,
qe vullneti kryevepër.

1) poplat zjarri hekur – rrumbull – predhat, gjylet

2) kokë-a – ikonë (këtu: gjë e shenjtë)

3) soje – prej saj (tij)

4) u dhanë – u dorëzuan

5) një grusht veta – shumë pak njerëz

Si ata ne s'patëm armë,
as të luftës rrëgullime,¹⁾

por një zemër e ca plumbë,
me pak buk'e pak ushqime.

N'aqë gjëmë, luftë tmerri
nuk luftonte pushk'e shkretë,
po që shpirti i gjall' i kombit:
Shqipëria dora vetë.

Prin me flamur, del nga shokët,
përmbi Vlorë të valojë:

«Le ta ngulim, — tha, — për jetë,
toka, deti sa të rrojë.

Tok'e shkabës dykrenare
me gjak ton' ësht' pagëzuar
dhe ky flamur faqe bardhë
ka gjithmon' për të valuar!»

Lart fortësës shkoi e nguli,
po përtej një plumb i shkretë,
erdh në zemër e goditi:
në vend ra, si trim me fletë.

Ne s'e dinim se kush ishte,
i gjyrmone²⁾ veç qëllimin,
ish luftar, mund i panjohur,
por sot kombi e njeh trimin.

E dha shpirtin i kënaqur,
se detyrën pat mbaruar,
se sot flamuri yn'i shenjtë
po tregon kush pat luftuar.

1) Pra ishte një luftë e pabarabartë si në njerëz, ashtu edhe në armatime, por populli shqiptar fitoi në sajë të sakrificave dhe të gjakut të derdhur.

2) i gjyrmone — e ndiqnim pas, merrnim shembull.

Për nj'atdhe ra, për lëvdatë,
për atë trimoshen Vlorë,
ra me nder, si bien burrat,
ra me flamurin në dorë!

1. Gjeni figurat letrare që përdor poeti për portretizimin e heroit dhe shpjegoni funksionin e tyre ideoartistik.

2. Analizoni figurën e heroit të rënë, botën, ëndrrat, idealet e tij. Si na e përshkruan poeti në çastet e betejës? C'mjete artistike e gjuhësore përdor? Gjejini këto dhe shpjegojini.

3. Depërtoni në botën shpirtërore të nënës. Cilat janë dëshirat, shqetësimet e saj? A mund të themi se figura e saj ka vlerë përgjithësuese? Pse? Duke u mbështetur në fakte historike ose në vepra letrare, flisni për nëna të tjera që kanë tipare të ngjashme me këtë.

4. Flisni për shokët dhe bashkëluftëtarët e heroit.

5. Nënivizioni skenat ku Asdreni përshkruan me realizëm jefën e mjerë të masave të shtypura, C'vepra të tjera nga Letërsia jonë ju kujtojnë këto vargje?

S H P E R B L I M I...*

— S'jam lypës, as i humbur e i pabesë,
në jam pa rroba, shorti ma ka thënë;
po unë gjithnjë kështu s'kam qenë,
e patë, trimërin'e kam dëftesë.

* Poezia u botua për herë të parë në organet e kohës më 1910 dhe pastaj në vëllimin «Endrra e lot» më 1912, pra në vitet kur shpallja e pavarësisë së Shqipërisë ishte e afërt. Te kjo poezi duket mendimi i qartë realist i Asdrenit për të ardhmen e Shqipërisë. Edhe pas shporrjes së të huajit vegjelia do të merrej nëpër këmbë dhe do të mbetej në thonjtë e pamëshirshëm të klasave të pasura.

Të pasurit, pohon poeti, nuk kishin tjetër ideal vec parasë; atdheu për ta ishte vetëm një fjalë boshe, që nuk kishte rëndësi. Këtë ide poeti do ta shprehë hapur në vjershëm «Shpërbimi». Këtu tregohet historia e një luftëtari patriot, që dha gjithçka për çështjen e qirimit të atdheut dhe për këtë mori si shpërblim mosmirënjojen dhe përbuzjen. Vjersha është ndërtuar mbi antitezën e gjendjes tragjike të luftëtarit të lirisë dhe të jetës plot dëfrime të të pasurve.

Luftova, gjakn' e derdha pa përtuar,
rrezikun e ndalova, mbajta «valën»,
ma zgjatët dorën ju, ma dhatë fjalën;
pra vij të ndajmë gjënë e fituar!¹⁾

— Kush ësht' ai që sot guxon pa leje,
që paqen na e tund, na sjell ngattrime,
na prish dhe prehjen, jetën plot dëfrime;
c'kërkon këtu i bir'i asaj së veje?

O nxirreni, të hyjë mos e lini,
të shporret! Eshtë rob e s'mund të flasë,
me shquelma bjerini, le të pëlcasë,
me grusht, me fshikull shpinës posht'e shtrini!

Rrëmbejeni, se vjen lart na bën hije;
s'na njeh si zot, u ngrit si valë deti;
dhe cili i pamundur ne na mbeti
që me rrëmbim luani thonjt'na i shtie!²⁾ —

1) Poezia është ndërtuar si një dialog i fuqishëm ndërmjet përfaqësuesit të vegjelisë dhe klasave sunduese.

Në dy strofat e para luftëtarë tregon të vërtetën e hidhur. Klasat e pasura, pasi fituan mbi të huajin, u kthyen kurrizin atyre që kishin derdhur gjakun për liri. «Gjëja e fituar» është atdheu i tyre i lirë, por të varfërit asgjë nuk fituan.

2) Duke vënë këto fjalë në gojën e përfaqësuesit të klasave të pasura, Asdreni u ka çjerrë deri në fund maskën atyre. Deri dje ata «i zgjatën dorën» fukarait, që të luftonte, kurse tani as që u bie ndër mend.

Një dit'e zezë ishte duke u gdhirë,¹⁾
lart qielli i kaltër ishte bërë sterrë,
në gjinjt'e mëmëve fëmija e mjerë
purtekë dridheshin me gjak të ngrirë!

Buçisnin malet, pushkët po kërcisnin,
ushtarët shtinin, gjaku lumë derdhej,
përpjetë flakë ngrihej, qielli verdhej;
siç duket se pa shembull gjëra ngjisinin.²⁾

Përse kjo gjëmë, c'faj, o zot, shpërblinin,
të mjerët, bukën që mezi e shikonin,
që s'dinin se ku shkelnin as ku rronin
e pa mëshirë togje dheut po binin?³⁾

Në dhë të tyre, t'huaj ishin vallë?
Të drejtë të mos kenë atje ku rrojnë,
po për të tjerë djersët t'u pikojnë;
mos shohin lumturi sa janë gjallë?

1) Me pak fjalë poeti thotë shumë. Këtu ai rikrijon tablonë e atyre viteve të përgjakshme dhe të rënda përfatet e popullit. Edhe figurat janë të fuqishme: «buçisnin malet», «gjaku lumë derdhej» etj.

2) Siç duket se pa shembull gjëra ngjisinin – ndodhnin gjëra të padëguara, të papara ndonjëherë, që nuk u gjeje shqegen në histori.

3) Pyetjet retorike janë përdorur nga poeti për qëllime të caktuara. Ato jepin gjithnjë protestën dhe zemërimin e luftëtarit dhe bashkë me të edhe të poetit.

Kjo protestë bëhet më e fuqishme në strofen tjetër. Vargu «Në dhë të tyre, t'huaj ishin vallë?» e shpreh më së miri këtë.

Fëmijt'e gratë maj'syngjive¹⁾ ngrihen,
më çdo dritare po pikojnë lot...
dhe gjakatart'e tërë kësaj bote
të dehur majë Olimpit²⁾ sot po shtrihen!

Gjer sipër era e gjakut afsh u ngrihet
dhe varret posht'u duken kopsht dëfrimi,
të ndehur «mundësit» mbi fron shkëlqimi:
dhe rrrotull s'shohin kur u shfaqen hijet!

Prej gazi t'marrët duart po fërkojnë,³⁾
me zemrën të kënaqur shohin varret...
po s'dinë se edhe fati i tyre varet
në dor t'atyre që sot i shqelmojnë!⁴⁾

1. Cilit motiv i përket kjo poezi e Asdrenit?
2. Çfarë fryme sollën këto vjersha të Asdrenit në poezinë e Rilindjes?
3. Vini në dukje karakterin demokratik të poezisë dhe qëndrimin e përparuar që mban poeti.
4. Krahasoni qëndrimin e Asdrenit ndaj parisë në këtë vjershë e në disa të tjera më poshtë, me qëndrimin e Çajupit ndaj klasave të pasura. Ç'të re sjell Asdreni?

1) syngji-a — bajonetë

2) Të dehur majë Olimpit — këtu ka kuptimin në krye të pushtetit për të shtypur vegjelinë.

3) duart po fërkojnë (shprehje frazeologjike) — gëzohen, kënaqen me fatkeqësinë e të varfërve.

Vini re dhe përdorimin e njësive të tjera frazeologjike në këtë poezi si: «i zgjat dorën», «jap fjalën», «i bëj hije», «me gjak të ngrirë» etj., të cilat ia shtojnë vlerat poezisë.

4) Dy vargjet e fundit flasin për botëkuptimin e përparruar të poetit: klasat e varfëra janë ato që do t'u bëjnë varrin klasave të pasura. Zemërimi i popullit një ditë do të shpërthejë.

ZERI I KRYENG RITESVE.

Shqiptarëve të pasur

Ne s'duam paqen, prehjen që t'ju prishim,
ne s'duam të na i falni pasuritë,
as dorë s'zgjatim-lypës s'e durojmë;

* *Kjo është nga poezitë ku qëndrimi klasor i poitet duket sheshit dhe shprehet me forcë. Tetëdhjetë vargjet e kësaj poezie janë një akuzë e fortë që demaskon qëndrimin e klasave të pasura ndaj çështjes së çlirimt të Shqipërisë nga pushtuesit e huaj.*

Poezia për herë të parë u botua më 26 qershori 1912 në organin «Liri e Shqipërisë», që dilte në Sofie. Më pas autori e përblođhi në vëllimin «Endrra e lot».

Vitet 1909-1912 u karakterizuan nga lëvizje të mëdha popullore kundër zgjedhës turke e që arriti kulmin me kryengritjet e Veriut. Asdreni, megjithëse në mërgim, ndiqte me interesim zhvillimin e ngjarjeve në Shqipëri. Ai e për-

në luftë që të veni ne s'ju grishim,¹⁾
të lini larg fëmijët dhe shtëpitë!
Asgjë për veten tonë s'u kërkojmë,

asgjë nuk duam, nukë,
veç armë dhe ca bukë!

*krahu me gjithë shpirt këtë lëvizje të masave të shtypura,
por dënoi edhe klasat e pasura, që jo vetëm rrinën duar-
kryq, por edhe pengonin kryengritjet e masave me ç'u mun-
dej, duke u tmerruar nga arritet e këtyre lëvizjeve.*

Refreni «Asgjë nuk duam, nukë! Veç armë dhe ca bukë...»
që u drejtohet klasave të pasura, nuk flet për përulje dhe
lëmoshë, nuk flet aq për ndihmën që duhet të jasin klasat
e pasura, por është më tepër një refren proteste dheakuze
ndaj qëndrimit të ulët e reaksionar të këtyre klasave.

Nëpërmjet antitezave të fuqishme Asdreni e shpreh mirë
këtë: «Ju rroni ndër shtëpi plot me shkëlqime. /Nuk dini
vojtje, lot edhe kujdese», ose «Ne derdhim gjakun lumë, ju
veç pasje...»

Pra, vetë poeti e thotë hapur se hendeku që ndan parinë
nga vegjelia, është i thellë. Demaskimi i parisë bëhet si
në planin patriotik (ajo s'ka asnje ndjenjë për atdheun dhe
mund ta shesë atë), ashtu edhe në planin shoqëror, si një
parazit që jeton me djersën e vegjëlisë.

Poezia pohon idenë se të varfërit, që shkojnë jetën me
vuajtje e lot, janë të pasur me virthitet e trimërisë, atdheda-
shurisë, kurse të pasurit janë të zhveshur prej cilësive të
tilla.

Ja si shkruan vetë Asdreni më 1912 në artikullin «Parë-
sia e Shqipërisë»: «Parësia na duket se të gjitha veprimet e
lëvizjet kombëtare të popullit i sheh si ca gjëra të paqena,
i sheh me një sy të shtrembër, si lodra foshnjarakë, në nië
anë sikur duke dashur të rrëfehet se është edhe me atë, po
më tjetër anë të mos e lërë edhe atë që e ka në dorë». Në vjer-
shën «Zëri i kryengritësve», poeti lartësoi patriotizmin e ma-
save të gjera të popullit dhe goditi fort egoizmin e klasave të
pasura.

1) grish – ftoj, thërres në një gëzim a diçka tjetër (këtu:
në luftë).

Me kryet lart në zjarr të luftës vemi
dhe gratë rrokin armët na gjurmojnë¹⁾;
me gaz e derdhim gjakun për lirinë!
Rrezikun s'e peshojmë ku që t'jemi,²⁾
prej zë trumbetash malet kur gjëmojnë,
të shkret'e lëmë vatrën e shtëpinë!

Jo gjë s'u duam, nukë,
veç armë dhe ca bukë!

.....

Ju rroni ndër shtëpi plot me shkëlgime,
nuk dini vojtje, lot edhe kujdese;
të zhveshur si ne pak sot mund që t'jenë.
si ju s'e shkojmë jetën me dëfrime,
po njerëz jemi gjith' t'asaj krijese;
për nderin, vatrën, kombin dhe atdhenë:

asgjë nuk duam, nukë,
veç armë dhe ca bukë!

Shtëpi ne kemi shpellat, vrimat, malet;
nesh rrotull gjith'armiq e tradhtorë
pa vetëdijë, njerëz të pabesë;
një argjendit, arit tjetrit sot i falet!
Kush helmin t'hedh, kush shpatën mban në dorë
dhe kush vëllan' armikut do t'ia shesë!

Për zotin, s'duam, nukë,
veç armë dhe ca bukë!

1) na gjurmojnë — na ndjekin pas, na pasojnë, përkrahin, luftojnë bashkë me ne.

2) rrezikun s'e peshojmë ku që t'jemi — nuk e marrim parasysh, nuk i trembemi rrezikut kudo që të ndodhem.

Kur flamuri kuq-zi bën valë,¹⁾ ngrihet,
shqiponja me dy krerë kur del ballë,
kur dridhet toka, topat kur shikojmë,
asnje prej nesh at'herë nukë fshihet,
po flamurin, të vdekur a të gjallë
me radhë do të bijem ta shpëtojmë!

Pra mos na lini, nukë,
pa armë dhe pa bukë!

Këtu, pra, njihet vlera, trimëria,
këtu rrëfahet forca e kombësisë,
se ne, me t'u bashkuar, tundet dheu,
i thyhet çdo armiku gjith'fuqia,
çel trëndafili i bukur i lirisë:
Përtërihet kombi, ngjallet Skënderbeu.

O, gjë nuk duam, nukë,
veç armë dhe ca bukë!

.....
.....

1. Gjeni dhe shpjegoni antitezat që paraqesin jetën e vegjëlisë dhe jetën e klasave të pasura.
2. Analizoni portretin moral të kryengritësve të lirisë.
3. Q'motive gërshtohen në këtë vjershë?
4. Cila strofë ju pëlqen më shumë? Pse? Ç'dini për kryengritjet e Veriut të viteve 1909-1912 dhe për disa nga figurat kryesore të këtyre lëvizjeve si Dedë Gjo Luli, Nora etj? Si e jep vjersha atmosferën e kohës?
5. Nxirrni dhe shpjegoni vargjet më të fuqishme që demaskojnë parinë.

1) bën valë – valëvitët

LULEKUQJA...*

Lulëkuqeja e mjera
asgjëkundi s'ka shtëpi,
e shkon jetën n'arrati,
ajo s'është si të tjera,
s'ka stoli!

Fushës, kodrës del vetiu,
verës ngrohet, dimrit ngrin,
vetë shkundet, vetë mbin
dhe, kur skuqet, vjen veriu
dh'e përtshin.

* Poezia duhet të jetë shkruar pas vitit 1908 dhe u botua më pas në vëllimin «Endrra e lot» (1912). Vjersha është krijuar mbi bazën e simbolit. Lulëkuqja për poetin është simbol i të varfërve, për të cilët s'ka kujdes njeri dhe shtypen pa mëshirë.

3 Nëpër këmbë gjith' e shkelin,
vend në kopshtet ajo s'ka,
dorë ndihme kurrë s'pa;
as e mbjellin, as e vjelin,
shkoi u tha...

Po veç ngjyrn'e saj si zjarri,
si një yll që xixëllon,
tërë bota e imiton,
është shenjë për së mbari
nga shikon.

Ajo ngjyrë kur zë shfaqet,
mbreti fronë shkon e le,
njerëz, robër fare s'sheh,
vjen e drejta del në faqe:
si zot je.

Ajo ngjyrë n'ato fletë
është shpresa që tregon
një të ardhme q'ëndërron...
është flamuri ynë vetë
që valon!

Ngjyra e lulëkuqes është simbol i lëvizjes për çlirimin
shoqëror të të varférve. Prandaj dhe poeti shkruan: «Ajo
ngjyrë kur zë shfaqet, / mbreti fronë shkon e le». Kjo tregon
se te poeti kanë ndikuar në një farë mase idetë socialiste,
por kjo mbeti diçka spontane për Asdrenin. Këto ide ai nuk
i thelloi në të ardhmen e nuk i përvetësoi në mënyrë sistematike e të plotë.

Rëndësia e kësaj vjershe qëndron në dëshirën dhe pa-
rapdjenjën e ndryshimeve të thella shoqërore, që shfaqen
përmes simbolit romantik të lulëkuqes.

KRERËVE TRADHTARË*

*autori u kjo zhvilluar kudoley
tradhtare.*

Ju njohim cilët jeni, s'ësht' nevojë
t'ju hapet libri i veprave të bëra,
se populli i përmend papra me gojë;
me kut i mat, me sy i sheh të tëra.

* Poezia duhet të jetë shkruar pas vitit 1908. Titulli i vjershës është i përligjur nga veprimet e parisë shqiptare të Rumanisë dhe të asaj të Shqipërisë. Poeti tani e kishte kuptuar se këshillat dhe qortimet nuk jepnin gjë. Ngjarjet e viteve 1910-1912 treguan se populli shqiptar nuk kishte ç'të priste më prej krerëve tradhtarë. Kishte ardhur koha që ata të demaskoheshin hapur. Klasat sunduese në kryengritjet e mëdha popullore herë kishin luajtur rolin e sehirxhiut dhe herë të tradhtarit.

Asdreni, duke e kuptuar thellë zhvillimin e ngjarjeve, u ngrit hapur kundër klasave sunduese dhe mori anën e maseve popullore. Prandaj ai shkruan vargjet më të rrepta që kishte njohur letërsia deri atëherë kundër parisë. Strofa e fundit është një paralajmërim i prerë për klasat e pasura: mëria popullore është rritur dhe kupa mund të zbraket.



Ju

Se çfarë shëmbëlltyrë t'ju përqasim,
me ç'emër botës mundim t'u tregojmë,
ne kot si trut'e mendjen do t'i vrasim;
me ju, e dimë, kombin turpërojmë!¹⁾

Si ferrat jeni, jetën q'e ndalojnë,
çdo bim'e lule e mbytni ndënë gjemba,
sa as dritë, as diell më s'shikojnë;
as gjaku s'u lëvrin ndër dej a rremba!

Si bisha e malit, gjahut kur i derdhi,
as gjurmë më s'i mbetet në ka rrojtur;
mëshirë s'keni, drojës ju nuk mverdhi
për shpirrat, jetën që ua keni shojtur!

Ju s'keni as shpirt, as zemër, dhembje s'ndieni,
përpara jush kur krah'e duar ndehen,²⁾
fytyrën, sytë mënjanë ua kheni
atyre shpresës suaj që ushqehen!

Karakteristikat e klasave

Sa lot nuk janë derdhur pa shteruar,
shtëpi sa s'kanë mbetur sot të shkreta;
sa zemra s'psherëtijnë sot pa pushuar,
theror q'u ranë krejt nën thonjt' e mprehta!

1) Në këtë strofë dhe në ato më pas, Asdreni ka dhënë gjithë karakteristikat e klasave tradhtare. Vini re leksikun që përdor poeti për të bërë portretin moral dhe për të dhënë pozitën klasore të tradhtarëve.

2) kur krah'e duar ndehen — kur të tjerët u kërkojnë ndihmë.

Prej gurit zemrën ju sikur e keni
që aspak s'e ndieni qarjen e rënkimin;
ju ligësit'e fajet s'mund t'i fshehni,
çdo e keqe këtu posht'e ka shpërblimin!

Përdhe u shtrinë shtyllat e mermarta;¹⁾
prej rrënje u prenë lisat madhështorë,
në vend të tyre hije ka të tmercta
dhe mbi rrënimet ngrihen shpirtmizorë!

Sot zëri i fortë i luanit²⁾ më s'dëgjohet
që malet i përcante si gjëmimi;
por zë bretkosash³⁾ posht'prej pellgu çohet
si këngë zie, këngë robërimi!

Mjaft, mjaft! Se u mbush kupa e hidhërimit,
gjarprinj pushoni! Helmin tej e shporrni,
mos dalim tej kufirit të durimit:
që më në fund se ç'mbollët ju të korrni!

1) Në mënyrë të figurshme poeti shpreh idenë se parësia e vjetër e kohës së Skënderbeut (të cilën poeti e çmon shumë) tani është zhdukur dhe parësia (kryesia) e sotme e Shqipërisë s'ka të bëjë fare me të vjetrën, sepse është degjeneruar dhe bastarduar.

2) i luanit – për Skënderbeun.

3) zë bretkosash – zëri i parësisë së sotme

1. Komentoni hollësishët strofën e parë e të fundit.
2. Ç'ka të përbashkët kjo vjershë me vjershat «Shpërblimi», «Zëri i kryengritësve»?
3. Duke u mbështetur në faktet historike si dhe në krimet e Rilindjes me karakter kundërfeudal, sidomos në shkrimet e Çajupit e të Asdrenit, zbërtheni kuptimin e var-gut.

«...Me ju, e dimë, kombin turpërojmë».

L U F T A R I L Y P E S *

Luftova për atdhe,
luftova për liri,
po veshin një s'ma ve,
as dorë s'm'jep njeri.¹⁾

* Poeti ka gjetur një rrugë origjinale për të shprehur zemerimin kundër të pasurve që tradhtonin atdheun dhe shfrytëzonin popullin deri në palcë. Këtë vjershë Asdreni e shkroi më 1922, pas epopesë së lavdishme të Vlorës, duke treguar tragjedinë e luftëtarëve të lirisë, të cilët u mashtruan nga klasat e pasura. Gjakun e derdhë populli fukara, por frytet i korrën të pasurit. Nëpërmjet rrëfimit tronditës të luftëtarit të mbetur rrugëve, pa asnje ndihmë e përkrahje, poeti zbuloi fatin tragjik të përfaqësuesve të vegjëlisë, që i vunë gjoksin çështjes së mbrojtjes së atdheut dhe më pas u flakën si plaçkë e vjetër.

Fjalët e luftëtarit lypës janë fjalë të vetë poetit, që i gjykon me rreptësi ngjarjet pas Luftës së Vlorës. Pavarësisht nga notat pesimiste, në fjalët e luftëtarit ndihet edhe besimi e krenaria se ai detyrën ndaj atdheut e ka kryer «Detyrën s'e kam la / Kjo helmet m'i shëron...»

1) veshin një s'ma ve – nuk më dëgjon kush, nuk kujdeset asnjeri për mua.

Pa kurrnjë ndihmë jam,
me plagë plot në trup,
fuqi më t'eci s'kam,
as rrobë s'kam mbi sup.

Kudo që kam trokit,
një derë nuk m'u-hap.
Rri jashtë prit e prit:
një copë bukë s'kap.

Armikut s'i jam tut,
në ballë i kam dal',
shpesh dërrmën ia kam fut
dhe hovin ia kam ndal.¹⁾

Ndër nete qiell pa yj,
shtrëngata vij me shi,
vend s'kisha ku të hyj,
s'di vetë qysh jam gdhi.

U treta për disa,
q'as njihnni komb, atdhe,
mbi frone sot ata,
që zhgryhen pa një fre.

as dorë s'm'jep njeri — nuk më ndihmon njeri.
Duke vënë këto dy shprehje në gojën e luftëtarit, poeti
tregon se ky është «shpërbëimi» që morën ata që derdhën
gjakun për lirinë e atdheut.

1) Masat popullore bënë një luftë të ndërgjegjshme, plot
sakrifica dhe vetëmohim për liri. Ata e bënë këtë se e donin
me gjithë shpirt lirinë e atdheut. Meqenëse bënин një luftë
të drejtë edhe fitorja u buzëqeshi atyre, pavarësisht se ar-
miku ishte i madh dhe i fuqishëm.

Me mburje posht'e lart
bërtasin me një zë,
se hynë mu në zjarr,
kur zjarri s'ishte më.

Kur isha në kushtrim
me shokët për atdhe,
ata gjithmon'pengim:
çdo çap na venin re.

Kur qe ndonjë rrrezik,
disa që rrinin larg,
sot rendin vrik e vrik:
s'mendohen veç për bark.

Të tjerë më shpirtligj,
që prap'na kanë vra,
sot bëhen miq për fiq,¹⁾
sikur më s'jan' ata.

Mundimet kush s'i njeh,
rrrezikun kush s'e pa,
tekdo të ngopur sheh,
q'as vunë kurrnjë krah.²⁾

1) Vini re ironinë therrëse të poetit që arrin deri në sarkazëm.

Shprehja «miq për fiq» do të thotë se ata që na vranë e na shtypën, sot bëhen miq vetëm për të ngrënë e për të pirë, rendin pas kolitukut e privilegjeve.

2) q'as vunë kurrnjë krah — që nuk ndihmuant fare në luftën për lirë.

S'pyesin sot kush je,
s'kujdesen se si rron,
kur shkon, kurkush s'të njeh:
syshtrembër të qëllon.

Fëmijët mos më keq,
të zhveshur un'i kam,
të zit'e ullirit heq,¹⁾
ndër mend'e mia s'jam.

Përjashta pa shtëpi
po bredh andej këndej,
të lyp si faqezi,
fëmijët që t'ushqej.

Një send vec më ngushëllon
detyrën s'e kam la,
kjo helmet m'i shëron
pa, fati im m'u pa.

• • • • • • • • •

1. Vjersha është thellësisht realiste, shpjegoni këto elemente.
2. Krahasoni botën morale të luftëtarit lypës me atë të klasave të pasura që jetonin në një luks të shfrenuar.
3. Gjeni momentet e pesimizmit në vjershë. Si duhen shpjeguar këto?

1) të zit'e ullirit heq — vuaj shumë, përballoj sakrifica të mëdha.

ERDHI DITA*

Erdhi koha, erdhi dita,
iku nata, doli drita;

* Asdreni, si vazhdues i traditës së rilindësve, e vuri penën e tij në shërbim të çështjes së Attheut. Vetë ai në mjaft raste e pat thënë këtë. Kështu, në një letër të vittit 1905 ai shkruan: «Dua të punoj për atdheun në një mënyrë që mund t'i sjellë dobi», ose, siç e thotë në parathëniej e vëllimit «Reze dielli», në poezitë e tij «pasqyrohet më tepër dashuria e atdheut, dashuria e atij vendi që të gjithëve zemra na qan me lot kur e kujtojmë». Në vjershën «Erdhi dita» del hapur dëshira e madhe e popullit tonë për liri dhe kumbon kushtrimi për kryengritje: «Qitni pallën si ju din».

Këtë vjershë Asdreni e shkrroi dhe e botoi në vitin 1901. Vjersha ishte bërë e njohur në rrrethet e patriotëve. Kjo duket edhe nga kartëpostalja që C. Topulli, B. Topulli, M. Gramenoja, H. Mosi etj. i dërguan poetit më 17 nëntor 1908 nga Kongresi i Manastirit, ku ndërt të tjera shkruanin:

«... Shumë na erdhi keq se nuk të kemi në mes tonë. Po të kënduam këngën tënde «Erdhi koha» («Erdhi dita») në mes tërë shqiptarëve».

ngrihi, trima, mos përtoni
këtë kohë ta shpëtoni!

S'është mjaft sa duruat
edhe tër' ato që vuat?¹⁾

Eshtë turp për emrin tuaj,
të mundohi për të huaj!

Qitni pallën si ju dini²⁾
edhe kordhën, në e kini,

me gjith'zemër e pa ndjesë
bini qenit të pabesë!

Mjaft me rrobën të çjerrë,
mbronи vatrën, mbronи nderë!

C'mbani duart si të thata?³⁾
Nxirrni shata edhe shpata,

ferrat, gjemba i qëroni,
lule të mbijnë, në doni.⁴⁾

1) Këtu poeti ka parasysh zgjedhën e rëndë shumë-shekullore të pushtuesve otomanë.

2) qitni pallën si ju dini — qitni pallën me guxim, sy-patrembur ashtu siç ka luftuar populli shqiptar ndër shekuj.

3) Ky varg dhe gati gjithë vjersha është si një qortim nga ana e poetit për shqiptarët.

4) Vini re alegorinë që ka përdorur Asdreni në këto dy vargje.

Për trima, ju, trima jini,
këtë dhe ju vet'e dini,

por q'dobi ësht' për atdhenë
kur s'ësht' ashtu si ka qenë!¹⁾

Shqipërinë ju në doni
nga ky rrezik ta shpëtoni,

kryet ngrini, zgjedhën shtini,
pastaj lumtur që të jini.

Në jini ju atdhetarë
dhe të thjeshtë shqiptarë,

bëjeni ju sot atdhenë
siç qe nënë Skënderbenë!

1. Cilit motiv i përket kjo vjershë e Asdrenit?
2. Cilën vjershë të Çajupit ju kujton kjo? Pse?
3. Duke pasur parasysh kohën kur u shkruan këto vjersha («Erdhi dita», 1901 e Asdrenit dhe «Shqiptar» – 1902 e Çajupit) flisni për rritjen e lëvizjes glirimtare të popullit tonë në fillim të shekullit të 20-të.
4. Nxirri figurat, idetë dhe elementet e tjera që ka të përbashkëta kjo vjershë me atë të Çajupit.

1) Ashtu si edhe për rilindësit e tjerë, edhe për Asdrenin periudha e Skënderbeut është periudha e lavdisë nga ku duhet marrë shembull. Poetit i vjen keq që Shqipëria nuk është më e tillë. Këtë poeti e shpreh edhe në fund të poeziës.

REPUBLIKA SHQIPTARE*

Sot bredh fjala gënjeshtare
prej disave mendjelehtë
se ky vendi yn' i qetë
parësi ka gjakatare,
gjë që s'ësht' e s'mund të jetë.¹⁾

* Vjersha satirike «Republika shqiptare» u shkrua në vitin 1925 dhe mbeti dorëshkrim. Në këtë mënyrë Asdreni del si një nga poetët e parë që demaskoi qysh në fillim regjimin shtypës të Zogut. Poeti e fshikulloi pa mëshirë shtetin reaksionar dhe obskurantist që u vendos në Shqipëri.

1) Vini re ironinë therëse që përdor Asdreni në këtë vjershë.

Se në bien dhe dëshmorë,
mund të ngjasë herë-herë,
faj që falet, faj pa vlerë,
se kjo botë s'ka shenjtorë:
kanë bërë edhe të tjerë!

Shteti ynë, shtet i mbarë,
ësht' një shembull drejtësie;
çdo që bën, s'e bën pa shije,
i shkon¹⁾ shokët, s'ka të ngjarë
në çdo punë qeverie!

• • • • •

përi pas kundërrevolucionit të vitit 1924. Asdreni përdori satirën e mprehtë për t'i çjerrë maskën demagogjisë së zyrtarëve reaksionarë, të cilët trumbetonin me të madhe se, nën sundimin e tyre, Shqipëria ndërroi faqe dhe po kthehej në një vend të zhvilluar evropian: në republikë. Autori e realizoi satirën e vet duke përdorur parodinë. Poezia është thurur si tregim i një përfaqësuesi të forcate të vjetra për sukseset e paqena të regjimit reaksionar. Kjo formë i ka dhënë dorë poetit të zbulojë gjendjen e rëndë në të cilën lëngonte populli.

Mendimi i poetit shprehet në strofen e fundit, ku shpërthen dhe patosi satirik që përshkon gjithë vjershën.

Asdreni e tall, e përqesh këtë «republikë» që është simbol i shfrytëzimit, i mjerimit dhe i vuajtjeve të vegjëlisë dhe që udhëhiqej nga parësia injorante dhe gjakatare me Zogun në krye. Vjersha e pabotuar «Republika shqiptare» si dhe disa të tjera dëshmojnë se Asdreni nuk i kishte braktisur idetë e mëparshme shoqërore politike dhe se ishte në dijeni të krijuimtarisë letrare antizogiste të Fan Nolit.

1) i shkon — këtu: ia kalon, është më i mirë (gjithnjë me ironi)

U tund deti, briti toka:
Shqipëria republikë!
Pun' e bukur, thon pa frikë,
veç zyrtarët që nga koka¹⁾
s'dinë shqip as gramatikë.²⁾

1. Komentoni dy strofat e fundit.
2. Krahasoni q'ka të përbashkët kjo vjershë me vjershat e Fan Nolit «Kënga e salep-sultanit» dhe «Sultani e kabineti».

1) koka — e thotë me të tallur për mbretin Zog.

2) Me këtë varg Asdreni thotë një të vërletë të madhe: zyrtarët e qeverisë së Zogut ishin anadollakë dhe analafabetë.

«KRIMBAT» E SHQIPĒRISË*

Ka mjaft kohë mjekësia
q'është ngritur në një shkallë,
sa çuditet njerëzia
dhe çdo shpez' a kafsh' e gjallë.
Çdo sëmundje e kërkojnë,
nxjerrin krimbat që e ushqejnë,
shpikin barna, i ndërtojnë
pér mikrobet, siç rrëfejnë.
Prej sëmundje së këtillë
vuan sot dhe Shqipëria;

.....

* Poezia satirike «Krimbat e Shqipërisë» u botua për herë të parë në vitin 1912 në Stamboll. Asdreni këtu fshikullon elementet antipatriotë, të cilët i quan «krimba» që përhapin «murtajën» në gjirin e shqiptarëve.

Vjersha, me gjithëse e zgjatur tepër, ka vlera të mëdha ideore dhe artistike; jep qëndrimin e prerë të Asdrenit ndaj armiqve të lëvizjes kombëtare të popullit shqiptar.

Veç në trutë u lëvrijnë
jo disave shqipëtarë,
brenda krimbat ven'e vijnë:
sot punojnë si të marrë.
Si më duket kjo sëmundje
që të vegjël u ka hyrë;
që në krye e gjer në fundje:
duken shenjat në fytyrë,

se nga trutë iu ka zbritur
majë gjuhës që po flasin,
ca thërresin si të mitur,
ca si qetë po pëllasin.
Dhe sëmundjen që po kanë,
mos u marrshin disa masa,
e përhapin më çdo anë,
do t'na mbushin mizash glasa!

* * *

* * *

Dhe ne duhet sa më parë
përkujdesje, pra, të marrim,
të këtyre shqipëtarë
shenjë qafës të iu varim!
Që t'i njoħë bota e tère
për sëmundjen që po kanë,
dhe të dinë c'i ka bërë
që iu hiqen gjith'mënjanë.
Se po lamë hapur vendin,

nisin shijnë si në lëmë,¹⁾
hyjnë vatrës, pshtyjnë këndin²⁾
si murtaja që sjell gjëmë.
Pa na mbushin muret, shkallat,
më çdo anë kudo jemi,
në shtëpitë, dhomat, sallat,
shkollat, librat, çdo që kemi!
Pra së bashku t'i përzëmë
si ca njerëz që mendojmë,
që të shporren larg ndë nëmë:
neve pranë s'i afrojmë!
Dhe mos paçim pak shëllirë
që t'u lagim gjuhë e gojë,
a në plehrat duk'i fshirë;
marrim shkopin ndë nëvojë.
Udhën prapë t'u rrëfejmë
tutje detit, mbanë qiellit,
ne mikrobet s'i ushqejmë:
le të venë prapa diellit!³⁾

1) shijnë si ndë lëmë — bëjnë si të duan si t'u dojë qejfi

2) këndin — këtu: dyshemenë, vendin ku ulemi.

3) prapa diellit — këtu: të mos u ndihet as nam, as nishan.

1. Motivoni arsyet e urejtjes së pakufishme që shpreh Asdreni për «krimbat» e Shqipërisë.
2. Komenton i pjesën e fundit të vjershës, që fillon me vargun «Pra së bashku t'i përzëmë...»
3. Sillni ndër mend poezi të tjera të autorëve të Rilindjes ku shprehet i njëjtë qëndrim ndaj elementeve anti-patriotë. Bëni krahasimin.

G J U H A S H Q I P E*

Lavdi ndër shekuj paç, o gjuhë shqipe,
lavdi për ty që jetë merr të rë,
me tingllin tënd të këndshëm kulmin hipe,¹⁾
ndër shoqet sot krenare zën'e mpreh.

* Poezia «Gjuha shqipe» u botua për herë të parë në vitin 1929 në organin «Shqipëria e re» dhe në vitin 1930 u përmblodh në vëllimin «Psallme murgur».

Duke iu drejtuar gjuhës shqipe, Asdreni vë në dukje shumë virtute të saj, faktin që ajo është zhvilluar dhe radhitet me shoqe të tjera, vështirësitet që ka përballuar në shekuj, qëndrueshmërinë e saj etj.

Poezia «Gjuha shqipe» është një sintezë poetike e mendimeve që ka shprehur qysh më parë Asdreni për gjuhën shqipe. Ja si shkruan ai në parathënen e vëllimit «Endrra e

1) kulmin hipe — u ngrite shumë lart

Si deti rrahuur valësh katallane,¹⁾
kur vjen shtrëngata rreptë q'e sulmòn,
dhe ti pas aq sulmimesh prej çdo ane²⁾
si shkëmb i fortë shekujt i qëllon.

E vdekur s'ishe, gjuhë stërgjyshore,
me ty gjalloi³⁾ një komb trim e krenar,
që s'u përkul ndër kohëra mirore,
q'armiqtë rrëth e merrnin drejt barbar.

Me ty s'u shkruan libra, përmendore
si pendë pate shpatën për shkëlqim:
me ty u lindën fryma ngadhënore⁴⁾
q'u shtrinë larg në Lindje e Perëndim!

lot» (1912): «Gjuha është ajo që e shquan njeriun nga ngjamësit që e rrethojnë si një komb i veçantë, ajo gjuhë që, duke e folur e duke e shkruar mirë, zëri i saj bën të buçasin malet, të ushtojnë pyjet, të murmurisin burimet, të ligjërojnë zogjtë...».

Nëpërmjet vargjeve të poesisë «Gjuha shqipe» poeti ka dashur të theksojë idenë se përparimi i çështjes kombëtare si dhe zhvillimi i gjuhës nuk e kanë rrugën të shtruar me lule, por me gjemba. Dhe vërtet: sa e sa rrebeshe e stuhi ka kaluar populli shqiptar. Por, siç shprehet dhe poeti, «shqiptarët, me gjithë aq e aq trazime e vuajtje, mund të themi e mbajtën gjuhën e vet, si një kujtim e ndjenjë atdhesie».

1) Katallan – figurë e përrallave shqiptare që përfytyt- rohet si një njeri div nga shtati, i egër e me një sy në ballë etj.

2) Këtu poeti ka parasysh faktin se armiqtë, duke dashur të zhduknin popullin shqiptar si komb, donin të zhduknin në radhë të parë gjuhën shqipe, si një nga tiparet e kombit.

3) gjalloi – jetoi (zakonisht për një jetë të vështirë)

4) ngadhënore – fitimtare, ngadhnjimtare.

Ti je thesari prindrit që na lanë;
si Leka, Burri, pas edhe çdo luftar,
ndër këngë e valle zonja hir të dhanë
me ty u mburr pellazgu milënar.¹⁾

Te ti qëndron virthytë i gjindjes sonë,
ti t'ardhmen me të shkuarën bashkon,
ti na tregon se ç'jemi përgjithmonë,
kur verbi²⁾ yt i bukur na tingëllon!

Bekuar qofshin gjith'ata të lumit³⁾
që brez pas brezi goja s'u pushoi,
të gjallë që të mbajtën; për të shumit
që ngjallja jote aspak ndër mend s'u shkoi.

Si zonjë e madhe mbaju kryelartë,
bëj të gjëmojë zëri yt hyjnor,
ndër vepra fryme mendje me së lartë
t'ia thonë zanat këngës mbi Tomor!⁴⁾

1) milënar — mijërvjeçar, i stërlashtë, e lashtë

2) verbi — (folja) — këtu: fjala

3) të lumit — të lumturit

4) Asdreni arrin deri në idealizimin e gjuhës shqipe.

1. Nën vizoni dhe shpjegoni vargjet që flasin për cilësitet e gjuhës shqipe.

2. Duke pasur parasysh edhe vjershën «Grekomanët» si dhe shkrime të tjera të rilindësve për gjuhën, fisioni përrugën e vështirë dhe heroike të zhvillimit të saj.

3. Komentoni hollësisht strofën që fillon me vargun «Te ti qëndron virthytë i gjindjes sonë»...

MALLI I ATDHEUT*

O zoçka të bukura, larg që fluturoni,
ju që të vrapuara erën e trazoni,
thoni-më, vallë; asaj udhe tek shkuat,
në malet e Shqipërisë nuk qëndruat?

As thoni-më, u lumtë goja edhe penda,
se të ju dëgjoj shumë, shumë ma kënda.¹⁾

* Poezia «Malli i atdheut» u shkrua në vitin 1903 dhe u botua po atë vit. Tema e mallit për atdheun ishte lëvruar edhe prej rilindësve të tjerë të mërguar në vise të ndryshme të botës, por Asdreni i jep kësaj teme një tingull original. Ndjenjat e atdhedashurisë shprehen këtu si ndjenja, të të gjithë shqiptarëve të mërguar.

1) ma kënda – dua, dëshiroj, ma ka ënda.

Tregoni-më me atë zë q'është si mjaltë,
se nuk mund të duroj; zoti ju faltë!

Vall'i patë ato brigjet që gjelbërojnë
edh'ato malet që aq e zbuluarojnë?
I patë ato fushat, pyjet dhe lumenjtë,¹⁾
ato fshatrat si edhe njerëzit e shtrenjtë?

Oh! Hiqni, zoçka të gëzuara, fluturoni,
në majat e larta të maleve qëndroni,
barisni kudo, me sy të gjitha i shihni,
që, kur të kthehi, të m'i thoni si ju dini!

Poezia është thurur si një bisedë e përmallshme, që bën poeti i mërguar me zogjtë shtegtarë. Ai u lutet dallëndyshëve t'i tregojnë për natyrën dhe për jetën e bukur të Shqipërisë. (Kini parasysh se Asdreni, ashtu si edhe poetë të tjerë, kur është puna për të shprehur mallin e tyre, lë më-njanë dhe nuk përmend gjendjen e vërtetë të Shqipërisë. Kjo është karakteristikë e romantikëve. Në krijimtarinë e më-vonshme të Asdrenit gjejmë një kuptim realist të gjendjes.) Dashurinë dhe mallin për atdhe poeti do ta shprehë edhe në krijime të tjera si «Mallëngjimi», «Malli i shkretë», «Shtëpia ime», «Dheu i huaj» etj.

Në lirikat e mallit për atdhe ai shkrua edhe dëshirën e tij për vatrën familjare, e sidomos për nënën, dhe me këtë frymëzoi gjithë shqiptarët e mërguar për t'i mbajtur të lidhur me familjet e tyre, me atdheun, me luftën për liri kombëtarë.

Një përfundim i rëndësishëm që del nga kjo, është se Asdreni e dënoi kurbetin si një plagë të rëndë shoqërore.

1) Nga fjalët me të cilat poeti u drejtohet zogjve, ndihet malli që ka për çdo gjë që lidhet me Shqipërinë; siç thotë populli, «e ka marrë malli edhe për gurët e sokakut».

Më thoni oshëtimn' e pyllit, gjëmimn'e malit,
këngët e mallshme¹⁾ të vashës e të djalit,
më thoni perëndimn' e hënës, lindjen e diellit,
ditën, natën edhe të qeshurën e qiellit!

Ëmbël të ligjëroni²⁾ zemrën të ma çmallni,
dëshirën të ma mbushni, shpirtin të ma ngjallni,
t'më çelni si pranvera, që çel trëndafilat,
edhe zë të më jepni, të këndoja si bilbilat!

1. Gjeni figurat letrare më kryesore, tregoni funksionin e tyre ideoartistik.

2. Nënëvizoni elementet poetike që të kujtojnë poemën e Naimit «Bagëti e bujqësi», Shpjegoni karakterin e tyre romantik.

3. C'illoj vargu e rime përdor poeti?

1) të mallshme – që të sjellin mall.
2) të ligjëroni – t'a thoni këngës.

T R A S H E G I M I *

Të rrish të bësh gjykime, me sa të shohin sytë,
të hysh në më të thellat, që t'apësh gjyq stërhollë,
me veprat e secilit, të pastër a të ndytë,
më duket pun'e rëndë, ta dini mir'e hollë.
Sa herë s'ju ka ndodhur që shpesh të shihni njerëz

* Poema e pabotuar me titull «Trashëgimi» përfundoi së shkruari në vitin 1935, kur regjimi feudo-borgjezi i Zogut ishte vendosur plotësisht dhe pasojat e tij duke sheshit. Këtu poeti përshkruan me hollësi dhe me realizëm gjenden e mjeruar politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të Shqipërisë në kohën e Zogut.

«Trashëgimi» është një demaskim i ashpër dhe i plotë i regjimit zogolian, i sistemit feudo-borgjezi me tërë bësirat e tij. Vepra kumbon si një akuzë e rreptë që Asdreni u drejtoi forcave reaksionare të kohës, të cilat, pasi uzurpuan

që, pa ta njohin veten, as çastin ta peshojnë,¹⁾
por mjeshtër dredharakë secili sipas vlerës;
me vlerë veç për prishjen, çdo shteg që ta kalojnë.²⁾
Sa veta s'ka kësyresh pa pikë zotësie,
me sjellje trashanike që s'maten me pëllëmbë,
çdo shpirti me një frysë që shquhet vetëdije

pushtetin, është hodhën vendin në mjerim dhe në skamje rrëgthëse.

Sundimtarët reaksionarë që përvetësuan atë që u arrit
me gjakun dhe sakrificat e patriotëve, poeti i karakterizon
me vija të forta satirike. Poeti flet me urrejtje për këta
njerez të cilët s'kishin menduar asnjëherë më parë për Shqipërinë. Elementët anadollakë Asdreni i krahason me këpu-
shat gjakpirëse në trupin e Shqipërisë. Përmes imtësive
shprehëse është nxjerrë në pah kundërpatriotizmi i tyre
urrejtja që kanë për çdo gjë të re, dhe lidhja e tyre e
ngushtë me botën e vjetër. Këta njerez përshkuhen si mi-
shërim i gjallë i vësreve më të shëmtuarë që lulzzonin në
Perandorinë Otomane, si paraqitizmi, amullia, dinakëria, pa-
besia etj. Portreti moral i tyre shihet edhe në qëndrimin
që mbajnë ndaj kulturës dhe përparimit në përgjithësi.

Amullisë dhe egoizmit që sundonte në realitetin cilifigaro-borgjez, Asdresi u kundërvur idealin e vet patriotik, të cilin e shihte të mishëruar te militantët e Rilindjes.

«Trashëgimi» është një tablo e gjallë e realitetit politik dhe shoqëror të vendit në vitet '30, por, duke prekur çështjet më thelbësore të jetës së masave punonjëse, poeti nuk ishte në gjendje t'u jepet përgjigje pyetjeve që e mundonin. Megjithatë, poema «Trashëgimi», në sajë të brendisë së thellë dhe meritave artistike, ka hyrë në letërsinë tonë si vepër e shënuar realiste.

1) që, pa ta njohin veten, as çastin ta peshojnë — në kuptimin pa qenë të aftë të shohin të metat e tyre dhe të çmojnë rrëthanat.

2) çdo shteg që ta kalojnë — për të kapërcyer situatat e vështira e për t'ua hedhur të tjerëve.

t'i bëhen urdhëronjës, ta marrin nëpër këmbë.
 Në qoftë se guximi q'e kanë si mburojë,
 të thyejnë vullnete, të shkelin mbi kufoma,
 për hir të madhërisë, q'e kan' ata si pronjë,¹⁾
 të dredhin çdo ndërgjegje a t'epin tru të njoma;²⁾
 mbi frone që të hipin, të duken se diç janë,³⁾
 të japin e të marrin⁴⁾ me frymë kotësie,
 për t'i treguar botës pushtetin plot q'e kanë,
 pa ta peshojnë veten n'u ka çdo rrobë hije.
 Këtu dëftehen çiltas se kanë tru të thatë,
 se kokën nuk e çajnjë më tej t'i shtien sytë,⁵⁾
 veç zotër që të jenë me dorën sa më gjatë,⁶⁾
 të tunden e të fryhen, si ta mos t'jet'i dytë.
 I sheh se po lëvdohen, se janë zemërgjerë,
 se dhembjet thell'i ndiejn, se janë mëshirtarë,
 çdo fjal' e tyre mjaltë, të mirën për të bërë
 të duken se çdo vepër e bëkan për të mbarë.
 Në punira njerëzimi s'i shkon ata një tjetër,⁷⁾
 rrëmujë e bënë pasjen,⁸⁾ me grusht të holla hodhën,
 lëvdatë kjo pa kripë, një përrallë e vjetër.
 Kuletën që ta çelin, askurrë nuk u lodhën.

1) pronjë — pronë

2) a t'epin tru të njoma — të mposhtin, të përulin të rinjtë

3) të duken se diç janë — të tregojnë veten se janë të ditur e të zotë, kur nuk janë të tillë.

4) të japin e të marrin — të përpiqen, të bëjnë ç'është e mundur.

5) më tej t'i shtien sytë — larg hundës së tyre, veç interesave dhe përfitimeve personale

6) me dorën sa më gjatë — për të përfituar sa më shumë për vete

7) nuk ia kalon kush, s'kanë shok në botë (gjithnjë me ironi)

8) pasjen — pasurinë

Lot bëhen sikur shtrydhin¹⁾ pér faqé me mandilen,²⁾
 kur bukë s'ke pér gojën, kur ndodhesh në të keqe,
 por, fati në ta pruri, me vaj ta kesh kandilen,³⁾
 mendsh prishen nga nakari, të ndehin mijra leqe.⁴⁾
 Me thonjtë majëmprehur, si mace ledhatare,
 si dhelpa sydinate dhe kobë kukuvaje,
 në prita dit'e natë dëshirash lakmitare,
 me vrik ta kapin gjahun, të prurin gjëmë e vaje.
 Nuk gjendet fjal'as emër në botë pér t'i nxirë⁵⁾
 këta të pafytyrë q'e shembin njerëzinë,
 që rendin pér të shqyer, në copë pér t'i grirë
 sa dorës tyre bijen sulmuar në greminë,
 pa shpresë njëj shpëtimi prej grushtit më të rëndë
 si shkëmb q'u rri krahnorit, q'as frymën dot s'e
heqin,
 të ndrydhur ndër mundime, të shtrydhur si një lëndë,
 nga thonjt'e bishës s'egër, që rri në gaz me dreqin.
 Armiq të kombësisë, por miq me të pér thela,⁶⁾
 me hov si shpendë nate në roje prapa murit,
 luftonjës të së drejtës, si vegla dhe tryela

1) lot bëhen sikur shtrydhin – higen sikur u vjen keq

2) mandile – shami

3) me vaj ta kesh kandilen – të bësh një jetë të mirë.
 pa shumë mungesa

4) ndehin mijëra leqe – thurin kurthe e intrigë pér të tjerët

5) Urrejtja e poetit ndaj njerëzve të tillë arrin kulmin.
 Pér të karakterizuar veprën e tyre të shëmtuar nuk gjen
 dot fjalë në botë.

6) Pra, këta që higen sikur duan interesat e atdheut dhe
 të kombit, janë armiq të betuar të tij dhe janë «miq» me
 të vetëm pér të fituar, vetëm pér «thela».

gjithmon'ushqim q'i dhanë litarit edhe hurit.¹⁾
Kësish e dashka fati dhe prijës shpesh në ballë
të kombit udhëheqës, të shtetit kujdestarë,²⁾

kalorës të Servantes ta mbajnë kapistallë:³⁾
të dukemi të lumtur, kur jemi për t'u qarë.⁴⁾

Këta të jenë vallë nj'ata që trashëgimin
e morën ta zmadhojnë, t'i japid nder e famë,⁵⁾
ndër vepra madhështore të bëra për kujtimin,
për lavd të mundit tuaj,⁶⁾ që kurrë syresh s'pamë?

1) ushqim q'i dhanë litarit edhe hurit — bënë masakrat
më çnjerëzore, vranë e prenë njerëz të pafajshëm si ua donte
qejfi atyre.

2) Vini re se si poeti shkruan me sarkazëm për Zogun
dhe pasuesit e tij.

3) Asdreni i krahason ata me personazhet e Miguel de
Servantesit, me Don Kishotin që «mbajnë kapitallin», pra
që drejtojnë të tjerët.

4) jemi për t'u qarë — jemi në ditë të hallit, jemi në
një gjendje shumë të vështirë.

5) Poitet i vjen keq që traditat e shkëlqyera të popu-
llit shqiptar, trashëgimi i tij, kanë rënë në dorë të xhahi-
lëve dhe të anadollakëve, të cilët, në vend që ta ngrenë lart,
t'i japid nder e famë, i kanë vënë kazmën dhe po e shkret-
tojnë.

6) E ka fjalën për trimat, për «burrat e shquar» që nxori
populli shqiptar nga gjiri i tij dhe që jetën e tyre e shkrinë
për të. Veprën madhore të tyre kërkojnë ta mbulojnë ata
që sot kanë fuqinë në dorë, thotë poeti.

Këta të jenë vallë gjurmashët me lëvdata,
 që posht'e lart bërtasin se kanë shpirt krijonjës,
 që hapin gojën gjerë me gjuhën si lopata,
 me buzët plot me jargë, si do gjarpinj helmonjës?¹⁾
 Fytyra prej shqiptari, por zemra krejt e huaj,²⁾
 me trupn' e tyre faqes, por shpirti u bredh përjashta
 të dish se ç'kanë brenda, lëkurën pak ua kruaj,
 do shohsh se s'gjen shenjtorë, por djaj me mish e
 rrashta.

Me maskë në fytyrë me të stërhollë prekje,
 të shfaqen plot virthyte ndër sjellje bujarie,
 për nderin, të vërtetën, dëshmori presin vdekje
 me mburrje, pa kufire, me frymë krenarie.
 Kur poshtë janë vaje ndër vojtje dhe mjerime
 që s'kanë një kafshore të bukës së përditme,
 që s'ngopen dot me fjalë, me festa dhe shkelmime,
 përveç uris'së zezë as n'ëndërr një të pritme.³⁾
 Të zbatbur e të zhveshur, ndër vrima dhe kasolle
 një lindet pesë vdesin, me kërmat mahin tokën,
 fëmijët si cirua prej ethesh e prej kolle,
 si fiq të thatë fishkur, mezi e shpien kokën.
 Më nj'anë sheh të ngopur, të ngjallmë, barkalecë,
 dinakë mu si dhelpra çdo send me grep ta heqin,
 më tjetrën sheh barkthatë pa mend si kastravecë,

1) Vini re se me ç'fjalë i portretizon poeti këta njerëz që janë turpi i kombit.

2) fytyra prej shqiptari, por zemra krejt e huaj — Me këtë Asdreni thotë një të vërtetë historike: klasat e pasura gjithnjë kanë tradhtuar interesat e atdheut dhe janë bërë vegël e të huajve. Ishte klika e Ahmet Zogut ajo që ia shiti Shqipërinë fashizmit.

3) një të pritme — një të ardhme

në diell e shi të rrahur, që s'din' asgjë të ndreqin...¹⁾
Ushqehen parazitë, pa bërë kurrnjë punë,
që rrojnë me gënjeshtra, që shesin çdo ndërgjegje;
me kokën plot me krunde, lëkurën mu si gunë,
shushunja gjak që thithin, pa dhën'asnë përgjigje.
Me fjal' i sheh se merren, me gjepura pa kripë,
me frymën mëndësie në lak për të shtypur,
biseda pa kuptime, të thëna sa për cipë:
themeli i kalbur fare, mendimi krejt i mbetur.
Veprime nënëdheshmë, vendime nënërrrogotë,
qëllime satanike për msyjtje shtazarake,
për ta kurrgjë s'ka vleftë dhe bota krejt n'u sostë.

.....

Gjurmashët e pazotë, të mitur si një dele,
me veprat burracake dhe me etjen madhërie!
Kam frikë, trashëgimi mos bëhet gjith fërtete:
ideali i ëndërruar mos zhduket si një hije!²⁾

1. Cilat vargje ju bëjnë përshtypje më tepër? Pse?
2. Nënëvizoni tablotë realiste ku përshkruhet jetë e mjerë e të varférve, e të shtypurve, për t'i krahasuar ato me vargjet me të njëjtën përbajtje në vjershat e Nollit e të Migjenit.
3. Gjeni llojin e vargut e të rimës që ka përdorur poeti në këtë vjershë. Cili poet tjetër ka përdorur vargje të tillë dhe në cilën poezi?

-
- 1) Nëpërmjet një antiteze të fuqishme Asdreni ka dhënë gjendjen e mjeruar të popullit shqiptar nën regjimin e satrapit Zog dhe jetën plot luks të klasave të pasura.
 - 2) Poeti e mbyll vjershën e tij i drithëruar për të ardhmen e këtij trashëgimi.

FISNIKET E SHQIPERISE*

Larg, larg, rrugën hapni shpejt,
se beu ynë vjen kaluar;
ja tek duket drejtpërdrejt,
pas me trimat t'armatosur!
Shih fytyra si i shkëlqen,
gjith'argjend edh'ar i veshur,
shih si fryhet, si dëften,
sikur ësht'me kashtë i ngjeshuri!

* Këtë vjershë satirike (që mbeti dorëshkrim) Asdreni e shkroi në vitet '30. Këtu poeti i demaskoi bejlerët si kriminelë dhe hajdutë, që pasurinë e tyre e kishin vënë duke grabitur popullin dhe duke vrarë ata që nuk u nënshtronshin.

Asdreni ka zbuluar me anë të të ironisë fytyrën me dy faqe të përfaqësuesve të klasave të pasura, të cilët e quanin veten «fisnikë», por në fakt qenë hajdutë, vrasës dhe gjakpirës të popullit fukara. Origjina e tyre prej «dere të madhe» u shërben si një maskë për të mbuluar dhe përligjur veprat e tyre zullumqare.

Që t'arrijë bej e hu,
të pangrënë u tretën shumë,
sa të tjerë kot për lumë
s'i përshkoi në plumb, ehu!
Qysh besoni se ësht' fisnik
a bir mbreti në fuqi,
çdo të madh mos e ka mik,
për të mbrojtur vegjeli?
A se s'ësht' aspak harbut
dhe se hiqet «Derë e Madhe»,
kurse natën del hajdut,
zhvesh sa shkojnë rrugës madhe?
Shkoi larg, se, gjith' sa ka,
i rrëmbeu nga varfëria;
vatër s'mbet, një lot ku s'ra:
Rroftë pra fisnikëria!

Thoni ç'përshtypje ju bën portreti fizik i beut në pjesën
e parë dhe si plotësohet figura e tij në pjesën e dytë.

N A I M F R A S H È R I *

Si një yll shum'i shkëlqyer
që natën ndrit meëmbëlsi
dhe çon dritë të pëlqyer¹⁾)
kudo që është errësi;²⁾)

* Kjo vjershë u botua pak kohë pas vdekjes së Naimit. Me nota patetike dhe tone elegjiake Asdreni bën një sintezë poetike të figurës së Naimit dhe të rolit që luajti ai në lëvizjen patriotike e në krijimin e një letërsie kombëtare. Vepra e Naimit ishte një dukuri me një domethënë të mëdha dhe në lëvizjen gjirimitare të shekullit XIX. Ajo u frymëzua nga kjo lëvizje dhe u vu në shërbim të saj. Fjala e Naimit ishte shprehje poetike e idealeve më të mëdha shekullore të popullit; si e tillë, ajo s'mund të lindte e shkë-

-
- 1) të pëlqyer — këtu: jetëdhënëse
 - 2) errësi (fig.) — errësirë

porsi lule bukur shfaqur
tërë kopshtin që zbuluron,
natyrën duk'e kënaqur
me erën e saj që lëshon;

ashtu dhe Naimi ndriti
mbi qiellin e Shqipërisë,
errësirën ia ngriti¹⁾
gjuhës edhe kombësisë.

Qaje, Shqipëri e mjerë,
lulen e bukur q'u shua,
atë vjershëtor të ndjerë²⁾
që këndoi trimnit' e tua!

Me një zë të perëndishëm
ty të lëvdoi mirësitë,³⁾
të dha jetë të dobishme,
të solli një rreze dritë!

putur nga kjo luftë popullore, ajo u fryshtua nga dëshira e shqiptarëve për liri. Natyrisht, në vjershën e Asdrenit nuk e gjemjë këtë konceptim dialektik të veprës së Naimit dhe të shtratit që e përkundi atë; herë-herë bien në sy tonet e ngritura, idealizuese, Megjithatë, vjersha shpreh vlerësimin e lartë që i bënë veprës së Naimit bashkëkohësit e tij, masat e popullit që u fryshtuan prej saj, një komb i tërë. Ky vlerësim materializon më së miri idenë se, kush «shkrihet e tretet si qiriri» për kombin dhe popullin e vet, mbetet i pavdekshëm në zemrën e këtij populli.

1) ia ngriti — ia hoqi, ia zhduku

2) i ndjerë — i dëgjuar, që ka bërë emër

3) mirësitë — virtytet, gjërat e mira

Me një mall të pashtuar
të ngjalli e të dha jetë,
për gjuhën duke punuar
si shqipëtar i vërtetë!

Prandaj kombi i tërë
qan me lot pa pushuar,
për shërbimet q'i ka bërë:
për jetë duk'e kujtar!

1. Duke u mbështetur edhe në vjershën e Çajupit për Naimin, fllsni për vlerësimin e lartë që i bënин veprës së Naimit bashkëkohësit e tij.

2. Komentoni strofën që fillon me vargun «Me një zë të perëndishëm...»

D I T E P R A N V E R E *

Dita gdhihet, çel agimi,
derdhet drita porsi ar,
zhduket nata, shkon qetimi,
dielli rrezet si burimi
i çon poshtë pos i zjarr.

* *Natyra dhe fshati ishin nga temat më të dashura të poitet. Ai vetë e kaloi vegjelinë dhe një pjesë të rinisë në natyrën e bukur të fshatit shqiptar dhe si mërgimtar shkruan me shumë përmallim. Jeta e fshatit tek Asdreni zakonisht nuk del me theksin realist që njohim te Çajupi. Por, si edhe Naimi, Çajupi e Mjeda, edhe Asdreni i këndoi natyrës shqiptare për të ngallur krenarinë kombëtare, për të forcuar shpresat e lirisë në ndërgjegjen patriotike të bashkatdhetarëve të tij. I rrëmbyer nga malli për natyrën dhe jetën e fshatit shqiptar dhe nga dëshira për t'i mbajtur bashkatdhetarët e mërguar të lidhur me Atdheun e me çështjen tonë kombëtare, Asdreni përshkroi peizazhe romantike plot shkëlqim, ku fshati shqiptar del me pamjen e ditëve*

Ndritten kodrat, fshati zgjohet,
lumi qiellin pasqyron,
fusha, bregu, ngjyra ndrrohet,
fletët dridhen, era ngrohet;
shkëmbi majën zbardhëllon.

Prej kasolles bagëtia
fushës dalin për ushqim,
derës jashtë Bukuria,
kur ndaj kroi, kur ndaj vija,
këngë dredh me përmallim:

Çunat lozin, vashat qepin,
plakat e urta tjerrin lesh,
nuset shkundin, tundin djepin;
burrat shatën, pleqtë grepin;
një mban fjalën, tjetri qesh.

Fushës zbresin tatëpjetë
punëtorët në mëngjes,
nëpër arat porsi bletë,
kush me vegël, kush me qetë;
me pëqinjtë përmi brez.

të festës, me zakone të idealizuara, dashuri, hëmoni.

Me motivin e natyrës dhe të fshatit lidhet edhe motivi i punës.

Natyra dhe puna, njeriu në punë e sipër janë shpesh
të bashkuar në poezinë e tij, sepse Asdreni nuk është mendon
natyrën pa jetën njerëzore dhe jeta për të nuk ka kuptim
pa punë të gjuar.

Vjen mesdita, grat'u shpien
buk'e gjellë me ç'u ndodh,
ndënë hije redhe¹) shtrihen,
hanë drekë, çlodhen, bien,
pastaj nisin punën mbroth.

Hijes gjethit, miza, grera;
zër'i zogjve rreth tingllon,
del gjahtari nëpër ferra;
vjen bariu plot me shqerra;
bujku çmallet e këndon.

Dita ngryset, vjen pushimi;
dielli ulet shkon në vend,
zhdukjet drita, erdh qetimi,
hëna rrezet si burimi
i derdh poshtë si argjend!

1. Cilat janë elementet romantike të vjershës dhe pse i karakterizojmë këto si të tillë?
2. Krahasoni këtë vjershë me vargjet e Çajupit për fshatin.
3. Nënvizoni vargjet që fasin për jetën dhe punën e bujkut, të fshatarit. C'ju bën përshtypje?
4. Gjeni figurat letrare, shpjegoni funksionin e tyre ideoartistik.

1). redhe — rrathë

D U A *

Mbi bar dua të prehem,
të këndoja, të dëfrehem!
Të shoh rrëth bagëtinë,
kur hanë edhe pinë.
Të shoh fushat e blera,
bimët kur i fryn era,
njerëzit kur punojnë
dhe çupat kur këndoja!

Ah! Dua edhe lulet
kur i shfaqin pekulet!

* Poezia «Dua» u shkrua nga Asdreni në vitin 1902. Poeti, ashtu si dhe rilindësit e tjerë, pothuajse tërë jetën e kaloi në mërgim. Prandaj dhe poezia e tij është mbushur plot mall për vendlindjen; ai i këndon asaj si një fshatar i thjeshtë.

Dhe fluturat që venë
mbi to, dua të jenë,
bilbili t'ia thotë,
dielli t'jet'i ngrohtë,
pylli të gjelbërojë,
qyqja të mos pushojë!

Dua dhe Shqipërinë,
se atje kam shtëpinë,
kur rrija nëpër ferrat
edhe lozja me shqerrat;
për këto kam dëshirë
edh'as dua më mirë,
veç atje dua të shkoj,
sa të jem e sa të rroj!

1. Cilit motiv i përket kjo vjershë?
2. Krahasoni me vargjet e Naimit e të Çajupit. Ç'anë të përbashkëta e të veganta vini re?
3. Krahasoni peizazhin e natyrës që na jep Asdreni, me peizazhin e sotëm të Shqipërisë.

V J E S H T A *

U zhduk vapa, shkoi vera
dhe bilbili më s'këndon,
erdhi vjeshta me të tjera
syri ynë q'i shikon.

Terret koha, hapen retë
ngjyrë plumbi përsëri,
duket prapë tjetër jetë
që natyra ndrron tashti.

* Kjo është një nga vjershat më të bukura të frysë-
zuara nga natyra shqiptare. Me një aftësi të rrallë vëzhguese
Asdreni paraqet ndryshimin që pësojnë elementet e natyrës
në një stinë të caktuar. Detajet e gjetura me vend krijojnë
me një plastikë të rrallë mjedisin e fshatit shqiptar. Sidomos
na bëjnë përshtypje skenat që paraqesin punën e palodh-
shme të bujkut, të njeriut të tokës. Kjo punë është garancia
e jetës, e nderit dhe e dinjitetit njerëzor.

Era fryn dhe fletët bien,
pemët zhvishen si nga mot,
mali, fusha më s'ka hijen
që po e kishte gjer më sot.

Qielli i bukur që dëfrente
trupin tonë, sot u terr,
më s'ka ngjyrën që shkëlqente:
si pasqyrë, si mermer.

Bukuritë janë zhdukur,
shiu e bryma zuri vend,
bari, lulet, kopshti i bukur
u ndryshuan më çdo kënd.

Dhe ligjeni i kulluar
që ndriçonte me shkëlqim,
e ka faqen të trazuar:
dridhet, tundet pa pushim.

Veç ngaherë me ëmbëlsirë
dielli rrezet na i dërgon,
natën hëna me një hirë
në argjend valët ngjyron.

Por e mirë është vjeshta,
sepse bujku gjith' punon;
për të vjelur sot ka vreshta,
nesër arat po lëron.

Njerëzia nga çdo anë,
posa ngrihen në mëngjes,
nëpër fushë çdo që kanë,
rendin, mbledhin me kujdes.

Pra më punë gjith'të rrojmë,
se veç puna ne na vlen,
sepse ndryshe s'trashëgojmë
verën tjetër që po vjen!

1. Komentoni strofën që ju pëlqen më shumë në përshkrimin e natyrës.
2. Gjeni strofat që flasin për punën e njeriut të thjeshtë, të bujput. Tregoni pse këtë punë poeti nuk e shkëput nga peizazhi i madh i natyrës.
3. Komentoni strofën e fundit. Pse themi se ka karakter moralizues?
4. Gjeni figurat letrare më shprehëse, tregoni funksionin e tyre ideoartistik.

M A L L I I S H K R E T E •

Tej përbri,
fshatit mbanë,
një shtëpi
plepit pranë.

Plaka rri
vatrës shtrirë;

* Motivin e kurbetit e trajtuan edhe poetët të tjerë të së kaluarës, sidomos Çajupi. Edhe Asdreni, si të tjerët, në këtë dukuri nuk sheh vetëm anën sentimentale, por e konsideron kurbetin si një plagë të rëndë shoqërore, që shler forcat e gjalla të popullit tonë dhe shkakton drama të rënda në familjet e kurbetçinjve. Edhe pse nuk arriti të zbulojë me thellësi shkaqet e thella ekonomiko-shoqërore të kësaj dukurie, kjo vjershë e dhembshme mbetet një akuzë e fortë ndaj shkaktarëve të vërtetë të kurbetit.

pa njeri,¹⁾
zemérngrirë!

Zjarri s'djeg,
flakë s'ngrihet,
këndit shteg
ndehet, shtrihet.

Bukë s'pa
plak'e mjerë,
ndihmë s'ka,
rrobat çjerrë!

Lotët sysy
pika rrjedhin,
shkel më dysh;²⁾
bota e mbledhin.³⁾

Djemtë larg,
mbetur vetë,
rreth përqark:
këndi i shkretë!

Flet e qesh
si një e marrë,
s'merr dot vesh
ç'i ka ngjarë.

1) Nëpërmjet fatit tragjik të kësaj nëne kërcure, Asdreni ka goditur kurbetin si një plagë të rëndë shoqërore të shkakuar nga klasat shfrytëzuese.

2) shkel më dysh — është kërrusur fare (nga hallet, nga pleqëria)

3) bota e mbledhin — kujdesen të tjerët për të

Djem kujton,
djem s'ka fare,
rreth kérkon...
mbet' qyqare!

1. Diskutoni lidhur me motivin e kësaj vjershe.
2. Krahasojeni fatin e kësaj plake me fatin e Lokes tek «Andrra e Jetës». Ku qëndron vlera ideore e kësaj poezie?
3. C'ka të përbashkët kjo vjershë me «Kurbetin» e Çajupit e g'e dallon?

PËRMBAJTJA

Faqe

Asdreni dhe poezia e tij	5
Një diell i ri	11
Betimi mbi flamur	13
Burri i dheut	15
Shpërblimi	24
Zëri i kryengritësve	28
Lulëkuqja	32
Krerëve tradhtarë	35
Luftëtar i lypës	39
Erdhi dita	43
Republika shqiptare	46
«Krimbat» e Shqipërisë	49
Gjuha shqipe	52
Malli i atdheut	55
Trashëgimi	58